



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDIM

Nr. 12/5, datë 30 / 10 / 2023

**PËR MOSPRANIM TË KËRKESËS PËR PËRFITIMIN E STATUSIT “INVESTIM/
INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E VEÇANTË”
PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT “HELIOS GREEN ENERGY”
ME SUBJEKT APLIKUES SHOQËRINË HELIOS GREEN ENERGY SHPK,
ME NUIS/NIPT: M26423202U**

Në mbështetje të neneve 9, 13, dhe 17 pika 5 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, Kreu I, pika 3/a të VKM Nr. 1023, datë 16.12.2015 “Për Nënsektorët Strategjikë dhe Zonat me Përparësi Zhvillimi” dhe Kreut II, pika 8, 10 e VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike vlerësoi se:

- Projekti i investimit propozon ndërtimin e një Parku Fotovoltaik me fuqi të instaluar 100 MWP, i cili do të ndërtohet në fshatin Lubonjë, Bashkia Selenicë.
- Vlera e investimit për projektin e propozuar parashikohet të jetë 66,024,000 (*gjashtëdhjetë e gjashtë milion e njëzet e katër mijë*) Euro.
- Pasuria e paluajtshme që preket nga projekti i investimit të propozuar ndodhet në ZK. 2504, Pasuria 2/1.

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE
VENDOSI:

1. Mospranimin e kërkesës për përfshirjen e projektit investues “Helios Green Energy”, me subjekt investues shoqërinë Helios Green Energy shpk, me NUIS/NIPT: M26423202U në procedurën e veçantë dhe mbështetjen që ofron ky status.
2. Zona është e pamënaxhuar, e ndarë me Ligjin Nr. 7501 dhe mungesa e regjistrimit i pengon marrjen e veprimeve të mëtejshme ligjore nga ana e institucioneve.

3. Projekti i propozuar është në mospërputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Selenica.
4. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet kërkuarit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTËR

EDI RAMA